

KËRKESË PËR PAJISJE ME AKTIN E MARRJES NË PRONËSI TË TOKËS BUJQËSORE TË ISH-KOOPERATIVAVE

<u>Emri i Shërbimit</u>	Kërkesë për pajisje me aktin e marrjes në pronësi të tokës bujqësore të ish-kooperativave
<u>Përshkrim i Shkurtër</u>	Subjekte të përfitimit të tokës bujqësore në pronësi dhe të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore janë personat fizike dhe juridike vendas. Ky akt jepet për përdoruesit faktikë të tokës bujqësore të ish-kooperativës, të cilët nuk janë pajisur me aktin e marrjes së tokës në pronësi
<u>Baza ligjore:</u>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” ▪ Ligji nr.9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” ▪ Ligji nr. 172/2014 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9948, datë 07.07.2008” Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” ▪ VKM nr.253, datë 06.03.2013 “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatra të ish kooperativave bujqësore”, të ndryshuar.
<u>Përfituesi</u>	Qytetarët
<u>Zyra Përgjegjëse</u>	Zyra/Specialisti i Drejtorisë Juridike
<u>Afati</u>	
<u>Tarifa</u>	Nuk ka tarifë
<u>Dokumente të nevojshëm</u>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kërkesën për pajisjen me AMTP për tokën që përdorin faktikisht, në të cilën përcaktohet numri kadastral i ngastrës ose emërtimi popullor, sipërfaqja e saj dhe kufitarët; ▪ Plan vendosjen e secilës ngastër që kanë në përdorim, të përgatitur nga një subjekt i licencuar, sipas kërkesave të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ku të pasqyrohen sipërfaqja, kufijtë e saj dhe kufitarët; ▪ Certifikatën familjare, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile, ku të pasqyrohen numri i anëtarëve të familjes përfituese ose individit, në favor të të cilit do të lëshohet akti i marrjes së tokës në pronësi, sipas gjendjes më 1 gusht 1991; ▪ Dokumentacionin që vërteton se janë përfitues, si rezultat i lëvizjes nga qendrat e tyre të banimit, me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave;
<u>Dokumenti/at e prodhuar si rezultat i shërbimit (outputs)</u>	Akti i marrjes së tokës bujqësore - ATMP
<u>Sporteli ku drejtohet qytetari për marrjen e shërbimit</u>	Sporteli në Bashki Sporteli në Njësinë Administrative